

FATOS KONGOLI  
**BALLO ME MASKA ose SHAKAJA E FUNDIT**

---

BOTIMET TOENA



**FATOS KONGOLI**

BALLO ME MASKA  
ose  
SHAKAJA E FUNDIT

BOTIMET TOENA  
Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Edona Marku Huqi

Redaktore letrare: Besa Vila

Kopertina *dhe* përkujdesja grafike: Erdita Oshafi

ISBN 9789928817662

© Autori *dhe* Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjete ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

**BOTIMET TOENA**

Rr. "M. Gjollësja" nr. 71, Tiranë 1023.

Kutia Postare 1420

E-mail: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

<https://toena.al/>

# 1.

Autori Katos Fongoli, - këtu e më tej thjesht K.F., - po rrinte në ballkonin e apartamentit, në katin e tretë të një pallati të vjetër katërkatësh, duke rrufitur me nge kafënë e mëngjesit, që ia kishte shërbyer bashkëshortja. Kjo, aktualisht pensioniste, dikur kishte qenë me profesion mësuese e gjuhës angleze në shkolla të ndryshme të kryeqytetit.

Prej vjetësh ai po zhytej gjithnjë e më shumë në atë që e quajnë dembeli e ëmbël. Prej vjetësh nuk i interesonte më asgjë, përgjithësisht nuk lexonte, aq më pak ndonjë gazetë. Gjithsesi, për të marrë vesh ç'bëhej, ndiqte emisionin televiziv "Koha

për t'u zgjuar” me pasqyrën e shtypit të përditshëm.

Atë mëngjes, në faqe të parë, gazeta “Kupola” jepte një lajm disi të pazakontë: në pikën turistike “Askund” do të organizohej një mbrëmje karnavalesh. Gazeta shënonte se hyrja ishte e lirë, kureshtarët që do të denjonin të ishin të pranishëm do të zbaviteshin. Me këtë rast, po në faqe të parë, gazeta botonte një fotografi të pikës turistike; një kullë shtatëkatëshe e tëra prej qelqi, që lejonte të shihje nga brenda-jashtë, por jo anasjelltas.

Ky lajm nuk i ngjalli kurrfarë kureshtjeje autorit K.F. Jo sepse atë e jepte fletushka “Kupola”, të cilën e konsideronte si mashë të qeverisë - financohej prej saj, ndryshe do të falimentonte. Atij thjesht iu duk pa ndonjë interes një mbrëmje karnavalesh, aq më pak të shkonte të merrte pjesë, edhe pse hyrja qenkej e lirë. Më pas diçka e paparashikuar e bëri të ndryshonte mendim, por, aty për aty, iu kthye të përditshmes së tij.

Në këtë të përditshme vendin kryesor e zinte një rregull: kudo që të ndodhej, kujdesej mbi të gjitha të merrte me vete telefonin celular. Këtë kërkonte edhe nga bashkëshortja: kudo që të shkonte, të mos harronte pa e marrë telefonin celular. Në

ndonjë rast të rrallë kur ndodhte e kundërta, ai përfshihej nga një ankth i vërtetë.

Zakonisht, pas kafesë së mëngjesit, rreth orës nëntë bashkëshortët zbrisnin në rrugën përpara pallatit. Lagjja ku banonin ishte e qetë, pa ndërtime të reja të larta, me ose pa leje, e gjelbëruar, pa lëvizje të shumta makinash. Mbi të gjitha plot me restorante, në përputhje me thënien sipas së cilës nuk mund të ketë lagje të mira pa restorante të mira. Si ecnin nëpër lagje nja njëzet minuta ktheheshin në shtëpi dhe të njëjtën shëtitje e përsërisnin rreth orës katër pasdite. Kryesorja: nga ballkoni i apartamentit atij i hapej një fushëpamje, që i lejonte të sodiste një hapësirë deri tutje, në malin përballë, ku në mot të kthjellët dallohej me sy të zhveshur pika turistike “Askund”.

Befas, ende pa e çuar deri në fund kafënë, tringëlliu zilja e celularit. Në ekran iu shfaq një numër i panjohur dhe ai doemos nuk e hapi telefonin. Në raste të tilla në anën tjetër i dilte ndonjë zë femëror, gjithnjë me reklamën e ndonjë malli, më së shumti të dyshekut të famshëm Dormeo. Tashmë ai nuk kishte nevojë për ndonjë dyshek të ri, qoftë dhe për të famshmin Dormeo, pra nuk iu përgjigj thirrjes dhe vazhdoi të rrufiste kafënë. Pas nja pesë minutash i mbërriti një mesazh.

“Përshëndetje zotëri K.F.

Para se t’ju zbuloj arsyen e vërtetë përse po ju shkruaj, e shoh të udhës t’ju lutem t’i lexoni deri në fund këto radhë.

Jam një i njohuri juaj i vjetër. Nuk po them mik, nuk besoj të kemi qenë miq ndonjëherë, në kuptimin që i jap unë kësaj fjale, ndonëse kjo është e diskutueshme. Duke mos dashur të luaj me durimin tuaj vërej se jam një nga ata që ju i keni burgosur libër pas libri, arbitrarisht. Thënë ndryshe jam një personazh juaji, i mbiquajtur Krist Tarapi. Kritika e specializuar letrare ka vënë në dukje se unë jam krijesa juaj më origjinale, madje disa shkojnë edhe më tej, thonë se tek unë ju keni transplantuar vetveten. Pak a shumë si në atë lodrën e fëmijëve që për të futur në kurth njëri-tjetrin recitojnë me pafajësi vargun “unë jam ti e ti je unë” dhe pas kësaj shtrojnë një pyetje që ma do mendja ta dini.

Nuk më bëhet vonë fare se çfarë thonë. Për të qenë i çiltër me ju, unë s’mund t’ju fal që më keni mbiquajtur Krist Tarapi. Në përputhje me këtë, të gjithë e kudo më thërrasin me tallje me nofkën zoti ‘Trapi’!

Të vij tani tek arsyeja e vërtetë e këtij komunikimi me ju. Nuk ishte dëshira ime. Ishte, po them, një mision që e mora përsipër



me kërkesën këmbëngulëse të të gjithë atyre që ju i keni burgosur mizorisht libër pas libri, pra një kërkesë e të gjitha personazheve tuaja, burra e gra, pa përjashtim. Në këto kushte, meqë e mora përsipër këtë mision jo të këndshëm, jam i detyruar t'ju zbuloj disa hollësi.

Takimi ynë do të mbahet në pikën turistike “Askund”. Kemi vendosur të jetë një ballo me maska. Këtu nis edhe poshtërsia e paçavures “Kupola”. Lajmin që ia dërgova unë për takimin, ku theksohet qartë se do të jetë një ballo me maska, ajo e ka ndryshuar qëllimisht me keqdashje përmes titullit “mbrëmje karnavalesh”.

Edhe një hollësi tjetër. Në bazë të informacioneve të mia, takimi me shumë gjasa do të kthehet në një larje hesapësh me ju. E kuptueshme, s'keni lënë gjë pa bërë e pa shkruar kundër krijesave tuaja mjerane, që po e presin me padurim ballafaqimin me ju.

Tani, siç thuhet, topi ndodhet në fushën tuaj, vendosni si t'ju duket më e arsyeshme. Nëse vendosni t'i përgjigjeni kësaj ftese, detyrimisht duhet të pajiseni me maskë.

Gjithë të mirat!

25 shtator, 2222”

Një copë herë të gjatë K.F. mbeti i përhumbur, pa u besuar syve.

“Bukur!”, tha me vete.

Tashmë as që e vinte në dyshim: do t'i përgjigjej sfidës së personazheve të tij. E lexoi sërish mesazhin për të dytën herë, pastaj për herë të tretë dhe vetëm pas herës së tretë i ra në sy diçka thelbësore: tjetri nuk e kishte sqaruar se kur dhe në çfarë ore do të organizohej balloja me maska.

Aty për aty u ngut të formulonte numrin e celularit të Krist Tarapit. Për një kohë të gjatë nga ana tjetër nuk iu përgjigj njeri. Ai këmbënguli sërish, derisa një zë automatik femëror i komunikoi se numri që kërkonte ai nuk ekzistonte. Pështjellimit, që e përfshiu, i vuri vulën data në fund të mesazhit enigmatik: 25 shtator, 2222!

Duke vënë në pikëpyetje vetveten e la ballkonin, vajti në dhomën e punës ku kalendari i madh me ngjyra, i varur në mur, vërtetonte se atë ditë ishte vërtet 25 shtator, por i vitit 2022 dhe jo 2222. Të njëjtën të vërtetë ia dëshmoi edhe kalendari i vogël me fletë, ku hidhte shënimet e përditshme.

I lodhur mirëfilli, kësaj katrahure, që luante me shifrën prej dyqind vjetësh, i dha një shpjegim të arsyeshëm: gjithçka ishte në

stilin e personazhit. Duket ky e meritonte nofkën “Trapi”!

Më kot shpresoi të merrte ndonjë telefonatë apo mesazh tjetër nga personazhi i tij, që nuk u bë më i gjallë, aq sa zuri të besonte se komunikimi me të kishte qenë një shpikje e fantazisë. Këtë gjasë ia hodhi poshtë gazeta “Kupola”. Përmes kësaj gazete, te rubrika e zakonshme “Koha për t’u zgjuar”, ai mësoi se mbrëmja e famshme e karnavaleve te pika turistike “Askund” do të mbahej atë të shtunë. Fletushka përsëriste njoftimin se hyrja do të ishte e lirë për këdo duke nisur nga ora gjashtë e mbrëmjes.

Pavarësisht nëntekstit tallës të “Kupolës”, e cila atë që do të ishte një ballo me maska parapëlqente ta quante mbrëmje karnavalesh, K.F. u ndje i lehtësuar. Atë ditë ishte e enjte, pra balloja do të organizohej pas dy ditësh. Tani i mbetej të zgjidhte vetëm një problem: cila do të ishte maska më e përshtatshme për të?

“Për besë, - tha kot më kot me vete, - për besë...”

Nuk i kujtohej se kur, ku dhe në ç’rrethana, ndoshta në një jetë tjetër rreth dyqind vjet të shkuara, po t’i përmbahej lajthitjes së qëllimtë të Krist Tarapit, dikush i kishte drejtuar pyetjen njëherazi origjinale

dhe të pabesueshme: cili do të ishte epitafi më i përshtatshëm që mund të vendosej mbi gurin e varrit të tij?

Ai nuk e pati në dorë të mos binte pre e këtyre dy pyetjeve. Pra, cila do të ishte maska më e përshtatshme për të nëse vendoste të merrte pjesë në ballon e paralajmëruar? Njëherazi kush do të ishte epitafi më i përshtatshëm që mund të vendosej mbi gurin e varrit të tij?

Më në fund, i lodhur e i mërzhitur, ia doli ta shmangte pyetjen rreth epitafit dhe të përqendrohej tek ajo aktualja: cila do të ishte maska më e përshtatshme për të tani që nuk e vinte në dyshim pjesëmarrjen te balloja e personazheve të tij?

Në një jetë e kohë tjetër, rreth dy shekuj të shkuar, një i afërm i kishte dhënë një shpjegim interesant rreth asaj që e quante “çështje e maskave”. Sipas tij, kudo e në çdo mjedis luhej një ballo me maska. Para se të dilte nga shtëpia për të vajtur në qendrën e punës, çdo individ, burrë apo grua, fytyrën e vërtetë e linte të mbyllur në kasafortë, në rastin kur i ndodhej një e tillë. Nëse jo, e linte diku në mjediset e banesës, ku të mundej dhe nuk dilte në rrugë pa u pajisur me maskën e sigurisë. Kjo do të

thoshte të shfaqej kudo e në çdo mjedis me pamjen e njeriut të bindur, të përvuajtur, që ecte vazhdimisht kokulur, që shihte vetëm hallet e veta, asgjë më shumë. Një dredhi naive, me shpresën se kështu do të mund t'ia hidhte lukunisë së kudondodhur të përgjuesve me pagesë apo vullnetarë në shërbim të qeverisë. Këta ishin në gjendje të dëshmonin për këdo edhe se sa lugë e pirunë i ndodheshin në shtëpi.

## 2.

Dikur, në rini të tij, më saktë në periudhën e shkollës së mesme, sporti më i parapëlqyer për të kishte qenë ngjitja çdo të diel në këmbë deri në pikën turistike “Askund”. Gjithmonë me të njëjtën shoqëri djemsh e vajzash. Për arsye të kuptueshme atij i ishte ngulitur në kujtesë vetëm njëra nga këto ngjitje. Në vitin e tretë të gjimnazit, në moshën shtatëmbëdhjetëvjeçare, kishte fjetur për herë të parë me një vajzë!

Rruga deri në atë vend, nëpër rrëpirën malore zakonisht, me ndonjë pushim aty-këtu, merrte nja tri orë. Atë ditë ngjitjen e vështirësonte edhe një rrethanë tjetër: bora

e një nate më parë. Ndoshta kjo që dhe arsyeja që diku ai mbeti prapa grupit derisa sytë i zunë një vajzë që po rrinte ulur pranë një gëmushe, me një çantë shpine pranë këmbëve, me kokën mbështetur midis duarve. Kur iu afrua, ai e preku lehtë në sup. Atëherë vajza ngriti kokën, si të zgjohej nga një gjumë i thellë.

- Ke nevojë për ndihmë? - e pyeti ai.

- Jo, - iu përgjigj tjetra shkurt.

- Pse po rri këtu vetëm? Ku i ke shokët dhe shoqet? Si të paskan lënë kështu, vetëm në mes të rrugës?

- Po të prisja ty, - ia ktheu ajo, - kam dyqind vjet që të pres...

Ai e vështroi me dyshim, ajo me siguri po tallej. Dhe vendosi t'ia kthente me të njëjtën monedhë.

- Edhe unë kam dyqind vjet që të kërkoj, - i tha, - më në fund ja ku të gjeta.

- E di? - ndryshoi bisedë vajza. - Sot unë kam ditëlindjen, mbush plot shtatëmbëdhjetë vjeçe.

- Unë kam mbushur shtatëmbëdhjetë vjeç vetëm para një jave, - ia ktheu ai.

- A pranon të jesh i ftuari im sonte? - e pyeti ajo. - Sigurisht, nëse nuk ke ndonjë plan tjetër.

- Asnjë plan, - ia ktheu ai.

- Edhe një kusht, - tha vajza, - unë s'jam kureshtarë të mësoj se si të quajnë. Të njëjtën gjë kërkoj prej teje, të mos bëhesh kureshtar për të mësuar se si më quajnë.

- Asnjë problem, - tha ai. - Tani të vendosim se ç'duhet të bëjmë. Unë dua të ngjitem deri te Kulla. Po ti, do të vazhdosh të presësh këtu?

- Jo, - ia ktheu vajza, - tani s'kam më asnjë arsye për të pritur këtu.

Ajo vinte pak më e shkurtër në trup se ai. Mbante një kapuç të bardhë që linte të dukeshin flokët ngjyrë vishnje. E gjithë qenia e saj çlironte një aromë vishnjeje. Vajza hodhi krahëve çantën e shpinës dhe ajo përpara, ai pas saj, vazhduan rrugën nëpër shtegun e rrëpirë malor.

Kur mbërritën pranë hyrjes së Kullës ishte ngrysur. Ndërkaq dritat në të gjitha katet ishin ndezur. Dera e hyrjes u hap, prej andej u vërsulën jashtë një grup djemsh e vajzash dhe zunë të luanin tërë hare me topa bore. Të papriturat i përgjonin në reception. Dhoma e prenotuar prej tij ndodhej në katin e tretë, bashkë me ato të pjesëtarëve të tjerë të grupit. Receptionisti, pasi i hodhi një vështrim dokumentit të tij të identifikimit, i



dorëzoi çelësin e dhomës. Gjatë kësaj kohe vajza qëndronte mënjanë e heshtur.

- Më vjen keq, - i tha recepsionistit kur ky iu drejtua asaj, - unë s'kam mundur të prenotoj qysh më parë ndonjë dhomë.

- Punë që rregullohet, - ia ktheu tjetri, - madje je me fat: e vetmja dhomë e lirë ndodhet në katin e shtatë. Atje është edhe e salla e restorantit. Një dokument identifikimi, ju lutem!

Vajza sajoi një buzëqeshje.

- Po t'ju them se pikërisht sot i kam humbur dokumentet e mia të identifikimit, a më besoni?

Recepsionisti ngurroi të përgjigjej. Atëherë, duke u futur në rolin e shoqëruesit të vajzës, K.F. e pa me vend të ndërhynte.

- Për këtë zonjushë, që sot ka ditëlindjen - mbush plot shtatëmbëdhjetë vjeçe dhe s'dihet sesi ka pësuar një lloj amnezie, mund të bëhem garant unë, miku i saj më i afërt. Pra, e quajnë Vishnje, të tjerat besoj s'kanë rëndësi. Do të qëndrojmë këtu vetëm një natë dhe nuk dihet nëse shihemi apo nuk shihemi herë tjetër.

Recepsionisti, një i ri rreth të njëzetave, i mësuar me çifte të tilla adoleshentësh, që mund të shpiknin lloj-lloj gënjeshtresh me

pafajësinë më të madhe, u prir të tregonte mirëkuptim, i dorëzoi vajzës çelësin e dhomës në katin e shtatë.

- Është më e lakmuara, - vuri në dukje.  
- Mban numrin 777, klientët e quajnë “Dhoma e fatit”!

- Qenke vërtet i shkathët, - i tha vajza atij kur u larguan nga recepsioni dhe vajtën pranë derës së një ashensori. - Të falënderoj edhe për emrin... E di që më pëlqen?

- Më bëhet qejfi, - tha ai.

Dhe deshi të shtonte:

- Në këtë mes nuk kam ndonjë meritë... Flokët e tu janë ngjyrë vishnje. Ti çliron një aromë vishnjeje. Në vend të buzëve ke dy kokrra vishnje.

Nuk foli. Pati përshtypjen sikur po riprodhonte një skenë të lexuar librash.

- Ç’do të bëjmë tani? - e pyeti ajo duke i hedhur një vështrim të ngulmët. - Nëse je penduar për marrëveshjen tonë, s’më mbetet hatri.

- Jo, - ia ktheu ai vendosmërisht, - por më parë duhet të takoj ata të grupit tim, në katin e tretë. T’u them se kam mbërritur shëndoshë e mirë... vetëm kaq...

Ky argument vajzës iu duk bindës.

- Mirë, - tha, - unë po ngjitem dhe të pres në katin e shtatë, në dalje të ashensorit.

Nja dhjetë minuta më vonë ai e gjeti pikërisht në dalje të ashensorit, ulur këmbëkryq, mbështetur pas një muri, me çantën e shpinës lënë përtokë. Sapo vajti pranë saj, ajo i drejtoi një pyetje të çuditshme.

- Të ka rastisur të flesh ndonjëherë në atë qe e quajnë “Dhoma e fatit”?

- Jo, - iu përgjigj ai.

- E mora me mend, - qeshi vajza.

Ai nuk e kuptoi përse qeshi tjetra. Aq më pak i ra në të se çfarë mund të kishte marrë me mend ajo.

- Po ti, - e pyeti tërë naivitet, - a ke fjetur ndonjëherë në atë dhomë?

- Kam fjetur, - u përgjigj vajza. - Ashtu si sot, kisha ditëlindjen, mbushja pesëmbëdhjetë vjeçe... Ka qenë hera e parë...

Ai këmbënguli në naivitetin e tij.

- Të solli ndonjë fat? - e pyeti.

- Patjetër... Ta shpjegoja, kur u takuam në shtegun me borë, kisha dyqind vjet që të prisja. Dhe më në fund ti erdhe.

- Edhe unë kisha dyqind vjet që të kërkoja, - ia ktheu ai, duke u futur në lojën e saj.

Në atë çast u ndje i sigurt; po të përkulej paksa, t'i jepte një të puthur, siç pati një yshtje, ajo nuk do ta kundërshtonte. Intuita e këshilloi të mos e bënte, do të kishte qenë një veprim i gabuar.

Pas shpinës së tyre, mbi mur, një shigjetë tregonte renditjen e dhomave sipas numrave përkatës.

- Druaj se recepsionisti është gabuar, - foli befasi ai, me frymëmarrje disi të prishur nga yshtja për t'i dhënë asaj një të puthur, - përveç dhomës 777 këtu duhet të gjendet edhe ndonjë dhomë tjetër, për mua.

Vajza u ngrit në këmbë.

- Recepsionisti nuk është gabuar, - vërejti.

Dhe i drejtoi pyetjen më provokuese.

- Më trego të vërtetën, ke fjetur ndonjëherë me një vajzë?

Ai ngurroi të përgjigjej. Vite të shkuara, - ende në klasën e katërt fillore, - kishte vajtur fshehurazi prindërve me djemtë e lagjes të lahej në lumë. Atje, buzë një pellgu, ishte bërë dëshmitar i një skene që e ruante të gjallë në kujtesë. Ulur mbi rërë, lakuriq fare, djemtë kishin zhvilluar një garë surrealistike, do ta quante aktualisht: për herë të parë në jetën e tij kishte mësuar se ç'do të thoshte

t'i bije me dorë ose, siç mësoi të thuhej më vonë, të masturboheshe. Djemtë e lagjes ishin masturbuar të gjithë, në garë se kush do të prishej i pari. Kështu ndodhi që më pas ai u pushtua nga magjia e të masturbuarit, teksa përfytyronte se bënte dashuri me vajza nga më të ndryshmet, me çdo vajzë që dëshironte, deri dhe me yje të kinemasë. Një mrekulli e vërtetë, e pakrahasueshme... Në këtë kuptim, virtualisht ai kishte një përvojë të pasur seksuale dhe mund të diskutonte gjatë rreth këtij subjekti. Fjala vjen rreth skenave erotike nëpër filma të ndryshëm. Kishte bindjen se ato nuk ishin aq të pafajshme. Askush nuk mund t'ia mbushte mendjen se aktorët dhe aktoret, në skena të tilla nuk shtireshin, ata bënin dashuri mirëfilli.

- Jo, - ia ktheu pas një ngurrimi të shkurtër, - s'më ka ndodhur të fle me ndonjë vajzë.

- Pse, - këmbënguli ajo, - ke ndonjë problem me vajzat?

- Jo, - ia ktheu ai, - s'kam asnjë problem me vajzat, thjesht nuk më është dhënë rasti.

- Atëherë lëviz, - i tha ajo, - eja!

- Ku të vij, - ngriti ai supet i hutuar, - më parë duhet të interesohem për ndonjë dhomë...

- E kemi një dhomë, - vërejti ajo, - nuk ke dëshirë të provosh fatin?

Ai nuk e zgjati. Ia doli të çlirohej nga gjendja e idiotësisë, mori çantën e shpinës dhe vajti pas saj, i bindur tashmë se fati i tij kishte një emër, e quanin Vishnje.

Ajo ishte një dhomë e zakonshme. Sapo futeshe gjendeshe në një mjedis paradhome, me dy kolltukë, një karrige dhe një tryezë në mes të tyre. Tutje ishte dhoma e gjumit, dera e hapur e së cilës lejonte të shihje një shtrat dopio.

- Kam nevojë urgjente të bëj një banjë, - tha vajza, e cila priu për në dhomën e gjumit dhe kërceu mbi krevat.

Ndërsa ajo zuri të zhvishej, ai po rrinte buzë krevatit. Për herë të parë po shihte një trup të zhveshur vajze dhe ra pre i një frike të beftë. Iu kujtua rrëfimi i pabesueshëm i një shoku të klasës. Gjatë pushimeve të verës, para se të futeshin në vitin e tretë, një vajzë e vitit të dytë kishte pranuar të dilte në një takim me të. Megjithëse vajza ishte treguar e gatshme të bënin dashuri, në takimin e parë ai s'kishte mundur t'ia plotësonte dëshirën. Kishte mundur t'ia plotësonte vetëm në takimin e dytë. Në të

parin ishte bllokuar nga ajo që dikush e kishte sqaruar përse ndodhte dhe e quanin pak a shumë impotencë emocionale.

- Zhvishu, pra, - e shkundi ajo dhe iu drejtua banjës.

Pa u çliruar ende nga frika se mos në çastin e duhur pësonte të mallkuarën impotencë emocionale ai u fut në banjë. Vajza ndodhej nën dush, me fytyrën të kthyer nga fluksi i ujit. Ai vajti nën dush, pranë saj. Ajo u kthye nga ai, ia hodhi duart rreth qafës, pastaj ia kaloi nëpër trup, deri poshtë, nën të.

Ai u err. Pa vetëdije zuri të përsëriste një skenë të njohur filmash që e ngriti peshë. Në kundërshtim me ligjin universal të rëndesës trupi i saj u bë pupël i lehtë. Kur ai e depërtoi ajo klithi dhe i dha një të kafshuar.

Vajza i dha disa të kafshuara më pas në shtrat. Ai e la të qetë vetëm ndaj të gdhirë, kur ajo, e harxhuar tërësisht, i tha “Mjaft!”. Ai mësoi prej saj se gjatë një nate pa gjumë, në përvojën e tij të parë seksuale paskej mundur të bënte dashuri me Vishnjen shtatë herë radhazi.

### 3.

E premtja në mëngjes e gjeti autorin K.F. si kurdoherë në ballkonin e apartamentit duke rrufitur kafënë që ia kishte shërbyer bashkëshortja. Deri në atë mëngjes ai ende nuk ia kishte zënë me gojë ballon me maska të personazheve të tij dhe ftesën e tyre për të marrë pjesë. Ndihej i sigurt për një gjë: edhe po ta vinte në dijeni, ajo nuk do të pranonte ta shoqëronte. Gjithë jetën i ishte përmbajtur një rregulli: në asnjë rrethanë të mos futej midis bashkëshortit dhe personazheve të tij.

- E keni shumë gabim, - i pëshpëriti një zë, - ajo së paku do t'ju jepte një këshillë për të zgjidhur problemin e maskës!



K.F., pati një përshtypje të fortë se këto fjalë ia kishte pëshpëritur i quajturi Krist Tarapi dhe nuk gabohej. Mirëpo në atë çast, e shpërqendroi diçka tjetër e pazakontë: tutje, përtej rrugës automobilistike, një turmë njerëzish, disa prej të cilëve mbanin maska e pankarta nëpër duar, zuri të lëvizte pikërisht drejt rrugës automobilistike. Më tej nga turma u shkëput një grup më i vogël individësh, të gjithë këta mbanin maska, e ky grup u derdh në rrugën dytësore të lagjes, për të përfunduar para pallatit ku banonte ai.

- E kuptoni tani se kush janë këta lapangjozë, që kanë ardhur tërë tangërrlëk t'ju sfidojnë përpara banesës suaj? - i tha Krist Tarapi.

K.F. nuk foli. Atij i tërhoqi vëmendjen një tip i mbështjellë me një pelerinë të zezë, të gjatë deri në fund të këmbëve, pa maskë. Ky fakt, domethënë që tjetri ishte pa maskë, i mundësoi të shquante qartë sytë e tij, tepër të njohur për të: ca sy të bardhë.

- Po ti, pjellë e ferrit, ç'kërkon këtu? - i tha me përbuzje.

Tjetri u zgërdhi.

- Më duket se kjo është e drejta ime...

Harrove se edhe unë jam një personazh juaji?

Atëherë ndodhi diçka që i shtangu të gjithë: nga grupi i individëve me maska u shkëput dikush. Ky, me një maskë prej japonezi, mbante në duar një pankartë ku shkruhej: “Nuk kam asgjë prej japonezi!”. E la pankartën mënjanë dhe lëshoi thirrjen “Ban Xaj”, që shumica e të pranishmëve nuk e kuptoi ç’do të thoshte dhe iu vërsul Syve të Bardhë, e rrëzoi përtokë me ca grushte të fuqishme. Pastaj u largua nga vendi i ngjarjes në një drejtim të paditur, siç thuhet zakonisht në raste të tilla.

K.F., si gjithë të tjerët, kishte mbetur pa frymë.

- Dreq o punë, - i tha Krist Tarapit, - mund të më shpjegosh se ç’ishte gjithë ky shpërthim dhune? Po autori i dhunës, kush të ketë qenë?

- Pavarësisht maskimit prej samuraj, - ia ktheu bashkëfolësi, - të gjitha shenjat më sollën ndër mend atë rrugaçin e pandreqshëm, humbësin e përjetshëm, siç e quajnë ca të tjerë. Me siguri duhet të ketë qenë ai rrufjani, Thesar Lumi...

Dhe shtoi:

- Të jam ankuar për emrin me të cilin më ke pagëzuar... me të drejtë! Sepse nuk durohet të tallen me ty lloj-lloj çapaçulësh duke të thirrur z. "Trapi". Mirëpo me sa shoh ka edhe më keq. Sepse nuk ka më qesharak sesa emri Thesar Lumi... Thonë se është një bredharak i madh, ngaqë s'di ç'të bëjë vërtitet nëpër botë, pa e ditur as vetë se ç'kërkon.

Me kaq mori fund edhe manifestimi i individëve të maskuar, me sa duket skena e dhunës kishte ndikuar për keq. Ata u larguan njëri pas tjetrit, derisa në sheshin para pallatit të autorit K.F., nuk mbeti më askush.

- Kjo ndodhi e shëmtuar, duhet të shërbejë si paralajmërim edhe për ju zotëri, - vërejtji Krist Tarapi. - Balloja me maska e personazheve tuaja mund të shfrytëzohet nga ndonjëri për të larë hesape të vjetra, të një kohe tjetër. Ka ca hesape që mbeten përjetësisht të hapura. Tek e fundit, një zgjidhje do të ishte të mos merrni pjesë në atë ballo, më mirë t'i shmangeni, nuk është e thënë që duhet të shkoni patjetër!

- Përkundrazi, - ia ktheu K.F., pa e fshehur një ngazëllim që po e ngrinte peshë

në ato çaste. - Ta them çiltërsisht, - shtoi, - nuk po të njoh, ç'janë këto këshilla disfatiste që më jep? Megjithatë të jam mirënjohës që m'u gjende. Tani shko bashkohu me të tjerët. Unë kam shumë nevojë që ti të jesh atje. Të lutem gjithashtu t'i dërgosh të falat e mia Thesar Lumit, t'i thuash se do të kisha shumë dëshirë ta takoja... Shko, pra, mos e zgjat! Ndërsa mua, deri nesër në orën gjashtë të mbrëmjes, do të më duhet të vendos disa pika mbi 'i'.

## 4.

E vërteta është se, i përfshirë në ngazëllimin e tij të pashpjegueshëm, deri të nesërmen në mëngjes ai nuk mundi të vinte asnjë pikë mbi 'i', përkundrazi. Ai u gdhi i turbullt, me një dhimbje të fortë koke dhe nuk arriti t'i jepte një zgjidhje kryesores: cila do të ishte maska më e përshtatshme me të cilën duhej të pajisej për të marrë pjesë në ballon e personazheve të tij?

Kështu e gjeti bashkëshortja, ulur në ballkonin e apartamentit, kur i shërbeu si zakonisht kafënë e mëngjesit.

- Mbrëmë nëpër gjumë je përpëlitur, - i tha ajo, - ke folur përçart.

- Pash Zotin, - ia ktheu ai me shaka, -  
çfarë dreqin kam thënë?

- Nuk është për të qeshur, - vërejti gruaja,  
- ia dhe një ulërime, sikur dikush të kishte  
vënë duart në fyt dhe po të mbyste!

- Bre, bre, - ia bëri ai, në një përpjekje  
të kotë për të çdramatizuar pohimet e  
bashkëshortes.

E mbante mend mirë makthin e një nate  
të kaluar, madje mund ta përshkruante pak  
a shumë kështu:

- Më ndodh ta shoh jo rrallë në ëndërr atë  
makth. Më bëhet sikur një qenie e shpifur  
më ndjek këmba-këmbës, dhe unë vrapoj  
me sa të mundem për t'i shpëtuar, dhe qenia  
nuk më shqitet, e më në fund unë ia dal  
të shpëtoj mrekullisht. Them mrekullisht  
sepse në çastin kur qenia pothuajse më  
kap, unë arrij të ngrihem lart, të fluturoj,  
e ky është çati i magjishëm i këtij makthi.  
Atëherë më del gjumi, dua ta përjetoj sërish  
çastin e magjishëm të fluturimit, por kjo  
është e pamundur.

Pasi i shërbeu kafënë, bashkëshortja i  
shprehu keqardhjen që atë ditë nuk do  
të ndodhej për drekë në shtëpi. Një grup  
shoqesh të vjetra të gjimnazit, siç ndodhte  
jo rrallë, sapo e kishin ftuar të bashkohej